



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Teoritë Bashkëkohore të Organizimit
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (sem. I)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrim i lëndës	Ky kurs u jep studentëve konceptet dhe njohuritë e avancuara të Teorive Organizative, të cilat janë të domosdoshme për çdo student pavarësisht drejtimit. Nëpërmjet këtij materiali studentët do të njihen me konceptet e organizimit si shkencë dhe si profesion. Gjithashtu, studentët do të kenë mundësinë të njihen dhe të kuptojnë procesin dhe teoritë kryesore të organizimit, si dhe vendimet, objektivat, strategjitë, politikat dhe planet e rëndësishme të biznesit. Lënda synon të njohë studentët me teoritë bashkëkohore të organizatës dhe menaxhimit të saj, përgatitjen e studentëve për formulimin dhe vlerësimin e alternativave të organizatave bashkëkohore të ekonomisë sonë ndaj tregjeve globale; përzgjedhjen e metodave më të mira për veprim dhe hartimin e planeve të detajuara për zbatimin e strategjisë, si dhe përgatitjen e specialistëve të rinj për sfidat e kohës. Lënda synon të nxjerrë në sipërfaqe njohuritë dhe informacionet bashkëkohore për organizimin dhe menaxhimin në përgjithësi në organizata duke identifikuar modele të reja organizimi dhe vendosjeje.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi qendron në përfitimin e njohurive dhe aftësive të reja të cilat studentët pajisen për ti aplikuar në tregun e punës. Ky kurs ka për qëllim të aftësojë studentët për sfidat dhe shancet që mund të prodhojë mjedisi përgjatë një organizimi të mirefilltë. Duke i përgaditur ata drejt një mjedisi dinamik dhe shumë fluid dhe mjaft ndryshimor dhe transformues.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1: Fiton njohuri aktuale gjithëpërfshirëse të teorive dhe kornizave organizative, të tilla si teoria e sistemeve, teoria e kompleksitetit dhe teoria e rrjetit; *NJ2: Mëson rreth qasjeve bashkëkohore për menaxhimin e ndryshimeve organizative, duke përfshirë metodologjitë e shkathëta, karakteristikat e menaxhimit të ndryshimeve etj; *NJ3: Eksploron konceptin e kulturës organizative dhe ndikimin e saj në punën e punonjësve, performancën organizative dhe menaxhimin e ndryshimit; *NJ4: Shqyrton rolin e inovacionit dhe teknologjisë në shoqëritë bashkëkohore me anë të përdorimit të mjeteve ditore, analitiken e të dhënave dhe teknologjive në zhvillim për të nxitur dhe avantazhuar konkurrues; *NJ5: Dije dhe njohuri të avancura mbi teoritë e bashkëkohore të organizimit të reja të reja që janë në histori të siq: dyfisht, nga teknologjia-në-ekologji etj; Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1: Zhvillon aftësitë për të analizuar dhe të gjitha strukturat organizative të ndryshme, duke përfshirë hierarkike, të sheshta, të vendosura në strukturën e ekipit që lidhet me efikasitetin organizativ, të lidhur me vendimarrjen; **A-K2: Studion teori dhe stile të ndryshme bashkëkohore të lidhshëm mbi efektivitetin e tyre në kontekste të ndryshme organizative dhe ndikimin e tyre në motivimin dhe performancën e punonjësve; **A-K3: Avancojnë aftësitë e të menduarit kritik dhe strategjik duke mësuar se si të zhvillojnë dhe zbatojnë strategji organizative që përputhen me sfidat dhe mundësitë bashkëkohore; **A-K4: Zhvillon aftësitë për të aplikuar teoritë organizative bashkëkohore në problemet dhe skenarët organizativë të botës reale me anë të rasteve studimore, simulime dhe ushtrime praktike për të kapërcyer hendekun midis teorisë dhe praktikave. Aftësi (A): ***A1: Aftësia për të analizuar dhe vlerësuar teoritë bashkëkohore të organizimit dhe për të aplikuar ato në kontekste të ndryshme organizative. <i>Sqarim:</i> Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K)
--	--

**Aftësi (A)			
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	5	1	5
Ushtrime në teren	-	-	-
Kolokviume, seminare	2	10	20
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	2	3	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet ,etj	2	4	8
Totali			150
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.			
Përshtatja e ECTS me orët totale: 150 orë ÷ 25 = 6 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	- Lënda zhvillohet në 15 javë në të cilat do të trajtohen konceptet teorike dhe do të ipen sqarime lidhur me procesin e teorive të organizimit, si dhe ushtrime që do të zhvillohen në formë me grupe në të cilat do të diskutohen shembuj konkret. - Kjo mënyrë e organizimit të ushtrimeve do t'ju shërbej studentëve për të përvetësuar në mënyrë logjike konceptet teorike dhe për ta lidhur në mënyrë organike teorinë me aspektet praktike të aktivitetit të biznesit. - Do të trajtohen raste të studimit të teorive klasike dhe atyre bashkëkohore përmes punës grupore duke nxjerr analiza dhe rezultate.		

Metodat e vlerësimit:	- Vijimi i ligjeratave/interaktiviteti 10% - Punim seminarik 20% - Testi i parë 15% - Testi i dytë 15% - Provimi 40%
Literatura bazë:	- Elvis Elezaj "Materiale të Autorizuara-Ligjerata, Teoritë Bashkëkohore të Organizimit, Pejë, 2023. - Berim Ramosaj "Materiale të Autorizuara – Ligjerata, Teoritë Bashkëkohore të Organizimit" Prishtinë, 2018. - Baki Koleci "Materiale të Autorizuara – Ligjerata, Teoritë Bashkëkohore të Organizimit" Pejë, 2021. - Boje, David M., Robert P. Gephart, and Tojo J. Thatchenkery, eds. <i>Postmodern Management and Organization Theory</i>. Thousand Oaks, CA: SAGE Publications, Inc., 1996. https://doi.org/10.4135/9781483345390. - Daft, R., & <u>Murphy</u>, J., & <u>Willmott</u>, H. (2020). <i>Organization Theory & Design: An International Perspective</i>. - Jones, G. (2013). <i>Organizational theory, design, and change</i>. Pearson, 2013.
Literatura shitesë:	T. Havar-Simonovich & D. Simonovich. "Contemporary Theory and Practice of Organizations: Understanding the Organization" ibidem, 2016. M. Hitt, R. D. Ireland, R. E. Hoskinsson. "Strategjia e Organizimit dhe Menaxhimit: Koncepti dhe Raste
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në teoritë klasike të organizimit
Java e dytë:	- Revolucioni Industrial mbi praktikat menaxheriale - Revolucioni industrial - Kontributet e klasikëve - Kontributi i Frederik Tayllor-it
Java e tretë:	Kontributi i Henri Fayol-it dhe Max Weber-it në teorinë e Organizimit dhe menaxhimit-Qasja Klasike
Java e katërt:	- Organizimi si funksion-katërmbëdhjetë parimet e organizimit dhe menaxhimit nga Fayol-i. - Teoria Administrative

	• Burokracia ideale e Weber-it
Java pestë:	• Përkrahësit e parë të qasjes së sjelljes njerëzore (Biheviристika) (Elton Mayo) • Kontributi i Robert Owen-it • Hugo Munsterberg-u • Studimet e Hawthorne
Java gjashtë	• Qasja Shkencore
Java e Shtatë	Testi i parë vlerësues
Java e tetë	• Qasjet moderne në organizim dhe menaxhim • Qasje Kuantitative • Qasje Sistemore • Qasja Kontingjente
Java e nëntë:	• Modelet bashkëkohore në organizim dhe menaxhim
Java e dhjetë:	• Menaxhimi grupit dhe ekipit
Java e njëmbëdhjetë:	• Menaxhimi i konflikteve në organizatë
Java e dymbëdhjetë:	• Qasja postmoderne në organizim • Qasja e Organizatave Mesimore
Java e trembëdhjetë:	• Qasja Mesimi dhe Vetë-organizimi • Qasja Përtej Menaxhimit nga burrat (Beyond of Man-agement)
Java e katërbëdhjetë:	• Qasja nga Teknologjia në Ekologji • Qasja Dyfishtësija organizative
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e mjetit identifikues në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.